



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 prill 2020  
Nr. Ref.:RK 1546/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI125/19**

Parashtrues

**Ismajl Bajgora**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev.nr.73/2019, të 19 marsit 2019**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjytar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar,  
Radomir Laban, gjyqtar,  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Ismajl Bajgora, me vendbanim në fshatin Bernicë e Poshtme, Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson Ali Latifi, avokat (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.73/2019] të 19 marsit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.4134/14] e 27 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.2915/12] e 11 qershorit 2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 maj 2019.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura para Gjykatës**

6. Më 30 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 30 gusht 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykatës Themelore iu kërkuar fletëkthesa si dëshmi e pranimi të Aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 4 shtator 2019, Gjykata Themelore e informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 maj 2019.

10. Më 11 mars 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

### *Procedura jashtëgjyqësore*

11. Më 20 shtator 2002, parashtruesi i kërkesës lidhi Kontratën [nr.200] në kohë të pacaktuar me Kompaninë e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: kompania “Siguria”), si udhëheqës i sektorit të dëmeve të kësaj kompanie.
12. Më 17 qershor 2003, kompania “Siguria”, përkatësisht Drejtori Gjeneral i saj, përmes Vendimit [nr.01-895], ia ndërpreu marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës duke filluar nga 16 qershori 2003.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, kundër Vendimit të lartcekur, përmes ankesës iu drejtua Bordit të Drejtorëve të kompanisë “Siguria”. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Bordi përkatës nuk është përgjigjur asnjëherë.

### *Procedura kontestimore*

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi kundër kompanisë “Siguria” në Gjykatën Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), me pretendimin se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin 7 të nenit 11 (Shkëputja e kontratës së punës) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 të 8 tetorit 2011 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut), sepse në kohën e nxjerrjes së aktvendimit të atakuar, e paditura, përkatësisht kompania “Siguria”, nuk i ishte nënshtruar ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale, baza këto mbi të cilat do të mund të ishte shkëputur Kontrata bazuar në dispozitën në fjalë.
15. Më 12 janar 2005, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit [C1.nr.233/2003] e (i) aprovoi si të bazuar, padinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e anuloi si të kundërligjshëm Vendimin [nr.01-895] e 17 qershorit 2013 të kompanisë “Siguria”; dhe (iii) detyroi kompaninë në fjalë që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës. Gjykata përmes Aktgjykimit përkatës, ndër të tjera arsyetoi se (i) Kontrata përkatëse nuk ka mund të jetë shkëputur bazuar në paragrafin 7 të nenit 11 (Shkëputja e kontratës së punës) të Rregullores së UNMIK-ut, sepse dispozita përkatëse duhet të interpretohet bashkërisht me paragrafin 1 të nenit 12 (Shkëputja e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje) të Rregullores së UNMIK-ut, ndërsa në rrethanat e rastit i padituri, përkatësisht kompania “Siguria”, nuk i është nënshtruar ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale; dhe (ii) paditësi, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, nuk është njoftuar 30 (tridhjetë) ditë më herët për shkëputjen e Kontratës.



16. Në një datë të paspecifikuar, kompania "Siguria" apeloj Aktgjykimin [C1.nr.233/2003] e Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të se drejtës materiale.
17. Më 17 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.706/2005] e refuzoi ankesën e kompanisë "Siguria" dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [C1.nr.233/2003] e 12 janarit 2005 të Gjykatës Komunale. Bazuar në shkresat e lëndës, Aktgjykimi i vërtetuar i Gjykatës Komunale, përkatësisht Aktgjykimi [C1.nr.233/2003] i 12 janarit 2005, morri formën e prerë në ditën e konfirmimit nga Gjykata e Qarkut më 17 qershor 2006.

#### *Procedura përmbartimore*

18. Më 14 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Komunale me kërkesën për përmbartimin e Aktgjykimit [C.nr.233/2003] të 12 janarit 2005 të Gjykatës Komunale, përmes të cilit ishte urdhëruar kompania "Siguria" që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin paraprak të punës dhe t'ia kompensojë pagat e parealizuara, duke filluar nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përkatësisht nga 16 qershori 2003, deri në ditën e kthimit në punë.
19. Më 29 tetor 2007, Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [E.nr.348/07] e aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e pagave të parealizuara për periudhën kohore 17 maj 2006 e deri më 31 maj 2007, në shumën e përgjithshme prej 19.799,51 euro, si dhe shpenzimet e procedurës, ato të ekspertit financiar dhe të avokatit. Siç sqaron Aktvendimi i lartcekur, vlera e kompensimit ishte përcaktuar bazuar në vlerësimin e një eksperti financiar të cilën gjykata përkatëse e kishte angazhuar për të bërë llogaritjen e pagave të parealizuara gjatë periudhës në të cilën Kontrata e tij ishte e ndërprerë, duke marrë parasysh që kompania "Siguria" nuk i kishte siguruar Gjykatës Komunale të dhënat e sakta përkitazi me të ardhurat e parashtruesit të kërkesës.

#### *Procedura kontestimore*

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës sërish paraqiti padi në Gjykatën Komunale duke kontestuar vlerësimin e ekspertit financiar përkitazi me vlerën e kompensimit, duke theksuar, ndër të tjera, se vlerësimi i ekspertit financiar nuk u bazua në Kontratën e punës, bazuar në të cilën paga mujore bruto e tij ishte 2,000 euro.
21. Më 16 dhjetor 2009, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [C1.nr.92/2007], (i) miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përkitazi me kompensimin e pagave të parealizuara për periudhën 1 qershor 2007 deri më 10 korrik 2007 në shumën e përgjithshme prej 2.330,00 euro, përfshirë edhe kamatën ligjore; ndërsa (ii) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, për kompensim "*më tepër se shuma e miratuar*" për periudhën 16 qershor 2003 deri më 2 qershor 2009 në shumën 81.207,46 euro, si dhe kërkesat për kompensim të kamatës ligjore për periudhën përkatëse, të kursimeve



pensionale dhe tatimit në pagë shumën e përgjishme prej mbi 39,000 eurosh. Nga dispozitivi i Aktgjykimit vërehet se Gjykata Komunale e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës vetëm për sa i përket periudhës 1 qershor 2007 deri më 10 korrik 2007, duke arsyetuar se përtej kësaj periudhe, parashtruesi i kërkesës ka punuar në organizata të tjera dhe rrjedhimisht ka realizuar të ardhura personale.

22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet për sa i përket pjesës refuzuese, ose i njëjti të prishet dhe çështja të kthehet në rivendosje.
23. Më 1 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktvendimit [Ac.nr.241/2010] e anuloi Aktgjykimin [C1.nr.92/2007] e 16 dhjetorit 2009 të Gjykatës Komunale, duke e kthyer çështjen në rivendosje.
24. Në seancën e shqyrtimi kryesor të Gjykatës Themelore të gjykimit të përsëritur, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që kompensimi për periudhën 16 qershor 2003 deri më 31 janar 2014 të jetë në shumën prej 182.466 euro, duke përjashtuar realizimin e pagave që tashmë kishte realizuar në procedurë përmbartimore. Ai, për më tepër, ka kërkuar që shuma prej 182.466 euro të llogaritet bazuar në paragrafin 1 të nenit 80 (Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës) të Ligjit nr.03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Punës), e cila sipas tij arrin lartësinë prej 364.932 euro, përfshirë edhe kamatën ligjore prej 3.5% deri 4%.
25. Më 11 qershor 2014, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.2915/12]: (i) aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi kompaninë "Siguria", që në emër të pagave të parealizuara t'ia paguajë atij shumën prej 17.834,22 euro për periudhën 16 qershor 2003 deri më 31 janar 2014, kontributet pensinale në shumën prej 1.922,89 euro, tatimin në pagë në shumën prej 3.720,99 euro, dhe kamatvonesën prej 3%, duke filluar nga nxjerrja e Aktgjykimit deri ne pagesën definitive; ndërsa (ii) refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë duke theksuar, ndër tjerash, se shumat e kërkuara ishin në kundërshtim me konstatimin e ekspertit; një pjesë të pagave në ndërkohë ia kishte paguar e paditura; dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për të drejtën në kompensim të dyfishit të vlerës bazuar në nenin 80 të Ligjit të Punës nuk qëndrojnë sepse sipas arsyetimit të kësaj gjykate: *"Gjykata vlerëson se kjo dispozitë ligjor nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë sic pretendon paditësi për kompensim të dyfishit të pagave, por mund të vie në shprehje për ndonjë dëmshpërblim tjetër që nga ndonjë bazë ligjore do të mund të i takonte punëtorit, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ka vlerësuar se paditësit nuk mund të i takoj ndonjë shpërblim tjetër përveç të kompensimit të pagave dhe të ardhurave tjera për të cilat është vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit"*.
26. Më 6 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të

gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe interpretim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës vazhdoi të kontestojë interpretimin e nenit 80 të Ligjit të Punës, me pretendimin se bazuar në këtë nen, ai ka të drejtë në *“dyfishimin e kompensimit të pagave”*.

27. Më 27 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.4134/14] e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe përgjigjen në ankesë të dorëzuar nga kompania “Siguria”, duke vërtetuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përfshirë edhe interpretimin përkitazi me nenin 80 të Ligjit të Punës, me përjashtim të pikës që ndërlidhet me kamatën ligjore, duke e detyruar kompaninë “Siguria”, që parashtruesit të kërkesës t’ia paguajë *“kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes se aktgjykimit të shkallës së parë 11.06.2014, e deri në pagesën definitive.”*
28. Më 16 janar 2019, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar aplikim të gabuar të së drejtës materiale, dhe më specifikisht nenit 80 të Ligjit të Punës, bazuar në të cilin dhe siç është cekur më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se i takon *“kompensimi i dyfishit të pagave”*.
29. Më 19 mars 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.73/2019] e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara përmes neneve 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës.
31. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se (i) nuk është zbatuar Aktgjykimi i formës së prerë, përkatësisht Aktgjykimi [C1.nr.233/2003] i 12 janarit 2005 i Gjykatës Komunale dhe për pasojë ai është dëmtuar financiarisht në shumën prej 182.466.00 euro, duke e përjashtuar kamatën prej 8% të përcaktuar përmes nenit 382 (Kamatëvonesa) të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në testin e mëtejshëm: LMD) për periudhat e caktuara kohore; (ii) Aktgjykimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 5 (Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit) dhe paragrafin 1 të nenit 80 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“punëtorit i takon e drejta për të kërkuar dyfishin e kompensimit të pagave në shumën e përgjithshme prej 364,932,00 euro, përfshi kamatën prej 8%, sipas nenit 382. paragrafit 2, të LMD-së”*; (iii) *“aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë, shkallës së dytë dhe shkallës së tretë janë kontradiktore”*; (iv) Ligji i Punës është interpretuar në dëm të tij si rezultat i interesave *“individuale, klasore, të nepotizmit dhe kleptokracisë”* dhe (v) kompania



“Siguria” ka kryer vepër penale, më specifikisht “Kompania „Siguria“ për mos ekzekutim të aktgjykimeve të formës së prerë, për kthim në punë, ka kryer edhe VP (vepër penale) që garanton Kushtetuta dhe KP, KPRK...”.

32. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) kompensimin e të ardhurave personale, sipas Kontratës së punës në lartësi prej dymijë (2,000) euro në muaj, duke filluar nga dita e largimit e deri në ditën e kthimit në punë; (ii) kompensimin e pagesave të trustit pensional duke filluar nga 16 qershori 2003 deri më 31 dhjetor 2011; (iii) llogaritjen e kamatës ligjore prej 3.5 %, dhe asaj prej 8% për periudhën 1 janar 2012 deri më 10 nëntor 2015 në pajtim me paragrafin 2 të nenit 382 të LMD-së; (iv) kompensimin prej 182.466,00 euro të vlerësuar nga eksperti financiarë; dhe (v) heqjen e shpenzimeve të procedurës gjyqësore, të llogaritura sipas tarifës së Avokateve, në lartësinë prej 3.184,80 euro.

## **Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31 i Kushtetutës**

#### **[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

### **Ligji nr. 03/L-212 i Punës**

#### **Neni 5**

#### **(Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit) ]**

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

#### **Neni 80**

#### **(Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës)**

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

## **Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve**

### **Neni 382 (Kamatëvonesa)**

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.

2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

35. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### **Neni 47 [Kërkesa individuale]**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*



*2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

36. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.189/2018] e 13 qershorit 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
37. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

38. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se në vitin 2002, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë pune me kompaninë “Siguria”. Kjo e fundit, në qershorin e vitit 2003, ia kishte ndërprerë parashtruesit të kërkesës marrëdhënien e punës. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, u kontestua nga parashtruesi i kërkesës fillimisht në procedurë administrative dhe më pas në procedurë gjyqësore, procedura këto që kishin rezultuar në favor të parashtruesit të kërkesës, përmes një Aktgjykimi [Ac.nr.706/2005] të 17 qershorit 2006 të Gjykatës së Qarkut dhe i cili konfirmoi Aktgjykimin e instancës më të ulët, përkitazi me kundërligjshmërinë e ndërprerjes së Kontratës së punës së parashtruesit të kërkesës. Më tej, parashtruesi i kërkesës kishte ndjekur procedurën përmbartimore e cila përfundoi përmes Aktvendimit [E.nr.348/07] të 29 tetorit 2007, duke i njohur parashtruesit të kërkesës të drejtën e kthimit në punë dhe duke i akorduar të njëjtit të drejtën për realizimin e shumës së përgjithshme prej 19.799,51 euro, për periudhën prej 17

qershorit 2006 e deri më 31 janar 2007. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesit të kërkesës nuk iu kishte mundur kthimi në vendin e punës nga kompania "Siguria", por shuma e lartcekur e kompensimit ishte realizuar.

39. Megjithatë, kjo shumë e akorduar e kompensimit u bë sërish objekt i procedurave gjyqësore. Fillimisht procedurat gjyqësore që ndërldheshin me kontestimin e vlerës së kompensimit, përkatësisht aplikimin e dispozitave ligjore në përcaktimin e kësaj shume u vendosën përmes Gjykatës Komunale në vitin 2009, dhe u kthyen në rivendosje nga Gjykata e Qarkut në vitin 2011. Ndërsa, në gjykimin e ri, Gjykata Themelore përcaktoi edhe vlerën shtesë të kompensimit prej 17.834,22 euro për periudhën prej 16 qershorit 2003 e deri më 31 janar 2014, dhe gjithashtu siç është sqaruar më lart, kontributet pensionale, të tatimit në pagë dhe kamatvonesën përkatëse, vlera kompensimi këto të cilat më pas u miratuan edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.
40. Parashtruesi i kërkesës vazhdon të kontestojë shumën e përcaktuar të kompensimit, duke pretenduar që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenet 21, 22, 23, 24, 31 e 49 të Kushtetutës. Në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 80 të Ligjit të Punës, i cili sipas tij i detyron gjykatat për të kompensuar paditësin në *"jo më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit"*, e që sipas tij, në rrethanat e rastit konkret, e arrin vlerën prej 364,932,00 euro, duke përfshirë llogaritjen e kamatave përkatëse.
41. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesë lidhur me (i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës për shkak të interpretimit të gabuar të Ligjit të Punës; dhe (ii) shkeljet e pretenduara të neneve 21, 22, 23 24 e 49 të Kushtetutës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) *Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit*

42. Në këtë aspekt dhe fillimisht, Gjykata thekson në kontekst të vlerësimit të përputhshmërisë së procedurave gjyqësore me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), praktika e Gjykatës dhe ajo e GJEDNJ-së përcaktojnë se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih rastet e Gjykatës: KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).



43. Për më tepër, në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata rikujton që esenca e pretendimeve të tij ndërlidhet me pretendimin për interpretim të gabuar të nenit 80 të Ligjit të Punës, interpretim ky i cili, sipas parashtruesit të kërkesës ka rezultuar në përcaktimin e një shume të gabuar kompensimi në rrethanat e rastit të tij.
44. Në kontekst të një pretendimi që ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të shqyrtojë ato. (Shih rastet e Gjykatës nr. K106/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; K1122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe rastin e Gjykatës K1154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60).
45. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: K106/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe K1122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe K1154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
46. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës K106/17, cituar më lart, paragrafi 38; K1122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe K1154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 62).
47. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore përkatësisht, e në rrethanat konkrete, gjykatat kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
48. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur një



gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

49. Në këtë aspekt, Gjykata duhet të thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar para Gjykatës (i) arsyet të cilat do të mund të mbështesin pretendimin se në rrethanat e rastit konkret, neni 80 i Ligjit të Punës është interpretuar nga gjykatat e rregullta në “*mënyrë qartazi të gabuar*”; dhe (ii) se si një interpretim i tillë, ka rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.
50. Gjykata megjithatë vëren se në kontekst të pretendimeve të tij për interpretim të gabuar të nenit 80 të Ligjit të Punës, parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i nenit 80 të Ligjit të Punës, ai duhet të kompensohet në dyfishin e shpërblimit që i takon sepse në interpretimin e tij, bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, shuma e kompensuar në rast të vërtetimit nga gjykatat se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë joligjore, “*nuk duhet të jetë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit*”.
51. Gjykata në këtë aspekt fillimisht vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me interpretimin e nenit 80 të Ligjit të Punës, janë adresuar dhe arsyetuar nga gjykatat e rregullta, fillimisht nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.2915/12] të 11 qershorit 2014, si në vijim:
- “...se kjo dispozitë, ligjore nuk mund të interpretohet në mënyrën e tillë, siç pretendon paditësi për kompensim të dyfishit të pagave, por mund të vije në shprehje për ndonjë dëmshpërblim tjetër nga ndonjë bazë ligjore, qe do të mund ti takonte punëtorit, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ka vlerësuar se paditësit nuk mund ti takoj ndonjë shpërblim tjetër përveç të kompensimit të pagave dhe të ardhurave të tjera për të cilat është vendosur, si në piken I të dispozitivit të aktgjykimit.”*
52. Për më tepër, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, duke i refuzuar si të pabazuara ankesën dhe revizionin respektivisht, e kanë konfirmuar interpretimin e Gjykatës Themelore përkitazi me nenin 80 të Ligjit të Punës.
53. Nga arsyetimet e mësipërme, Gjykata verën se gjykatat e rregullta i janë përgjigjur parashtruesit të kërkesës, lidhur me pretendimin se atij, në bazë të dispozitave të nenit 80 të Ligjit të Punës, i takon dyfishi i shumës në lartësinë prej 182.466 euro. Gjykatat e rregullta i vlerësuan si të pabazuara këto pretendime, me konstatimin se e drejta materiale është zbatuar në mënyrën e duhur sepse “*paditësit nuk mund ti takoj ndonjë shpërblim tjetër përveç të kompensimit të pagave dhe të ardhurave të tjera për të cilat është vendosur, si në piken I të dispozitivit*”.
54. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta nuk kanë “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, aplikim i cili do të mund të rezultonte në



*“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës.

55. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me nenin 80 të Ligjit të Punës ishin trajtuar dhe sqaruar nga gjykatat e rregullta, dhe së në tërësinë e procedurës, nuk rezulton se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo kanë interpretuar ligjin e aplikueshëm në mënyrë arbitrare. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës, KI99/19, me parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 46).
56. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës përtej pretendimeve që ndërlidhen me nenin 80 të Ligjit të Punës, para Gjykatës gjithashtu pretendon (i) interpretim të gabuar të nenit 5 të Ligjit të Punës; dhe (ii) mos ekzekutimin e Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të vitit 2005.
57. Përkitazi me çështjen e parë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës vetëm i referohet kësaj dispozite dhe para Gjykatës nuk ka paraqitur asnjë argument në mbështetje të këtij pretendimi. Për pasojë, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata nuk do të shqyrtojë më tej këtë pretendim. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; dhe KI187/18 dhe 11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykim i 29 korrikut 2019, paragrafi 73).
58. Ndërsa, përkitazi me të dytën, përkatësisht ekzekutimin e Aktgjykimit [C.nr.233/2003] të 12 janarit 2005 të Gjykatës Komunale dhe i cili është i formës së prerë nga 17 qershorit 2006, Gjykata thekson se Gjykata Komunale, përmes Aktvendimit [E.nr.348/07] të 29 tetorit 2007 ka vendosur në procedurë përmbarimore për ekzekutimin e këtij Aktgjykimi, dhe se shuma e kompensimit të caktuar përmes këtij të fundit është përmbaruar në favor të parashtruesit të kërkesës. Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk është kthyer në vendin e tij të punës në kompaninë “Siguria”, megjithatë, (i) që nga viti 2007, parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk e ka ngritur këtë pretendim para gjykatave të rregullta; (ii) që nga viti 2008, parashtruesi i kërkesës kishte vazhduar procedurat gjyqësore vetëm duke e kontestuar shumën e kompensimit dhe e cila iu kishte akorduar përmes këtij Aktgjykimi; dhe (iii) Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.2915/12] të 11 qershorit 2014, duke marrë parasysh edhe faktin që parashtruesi i kërkesës nuk ishte kthyer në vendin e punës, i kishte përcaktuar atij kompensimin shtesë prej 17.834,22 euro, duke shtuar edhe shumat e nevojshme përkitazi me pensionin, tatimin në pagë dhe kamatat e nevojshme. Këto të fundit, parashtruesi i kërkesës mund t'i realizojë duke ndjekur dispozitat përkatëse të procedurës përmbarimore.
59. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore sa i përket nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

60. Gjykata më tej rithekson se, në parim, “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substancialë*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës përkatëse. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 48; dhe KI49/19, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim për papranueshmëri i 8 janarit 2020, paragrafi 55).
61. Kjo nënkupton, se palëve duhet mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; duhet akorduar mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që janë relevante për zgjidhjen e një rasti janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29). Gjykata konsideron se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.
62. Më tej dhe në fund, Gjykatat thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
- (ii) *Sa i përket pretendimeve tjera të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave kushtetuese*
63. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të neneve 21, 22, 23, 24 dhe 49 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI136/14, cituar më lart, paragrafi 33; dhe KI187/18 dhe 11/19, cituar më lart, paragrafi 73).
64. Megjithatë dhe sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 24 të



Kushtetutës, Gjykata rikujton qëndrimin e saj parimor se trajtimi mund të konsiderohet i pabarabartë dhe diskriminues nëse një individ është trajtuar ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të njëjta dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për të qenë i arsyetuar, trajtimi i ndryshëm në rrethana të njëjta duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih rastin e GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, paragrafi 33). Parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur asnjë pretendim për trajtim të pabarabartë, përtej theksimit se ai është dëmtuar si rezultat i interesave “individuale, klasore, të nepotizmit dhe kleptokracisë”. Ky pretendim i parashtruesit të kërkesës nuk është i bazuar në asnjë argument dhe rrjedhimisht nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

65. Gjykata në këtë aspekt thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
66. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës.
67. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) e 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 mars 2020, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

*Gresa Caka-Nimani*

Gresa Caka-Nimani



*Arta Rama-Hajrizi*